



Viti i trembëdhjetë i botimit, mujore, Nr.6 (149) Maj 2011
 gazetamokra@yahoo.com Kryeredaktor: FLORI SLATINA
 www.poradeci.com/mokra

ÇMIMI 20 LEKE

Mokra, tani edhe më afër

Nis ndërtimi i autostradës Tiranë-Elbasan, investimi më i madh publik i qeverisë "Berisha". Autostrada do të jetë segmenti më nevralgjik i Korridorit të 8-të, dhe do të shkruajë ndjeshëm distancën e Tiranës me Elbasanin, por njëherësh edhe me Pogradecin e Mokrën në veçanti. Tashmë Në Mokër mund të shkohet për dy orë!

Kryeministri Sali Berisha mori pjesë në ceremoninë e nisjes së punimeve për ndërtimin e Autostradës Tiranë-Elbasan dhe tunelit të Kërrabës, si pjesë e kësaj autostrade. Në shenjë simbolike, kryeministri Berisha shkeli butonin e detonimit për shpërthimin e parë në gërmimet për tunelin e Kërrabës. Kryeministri tha se pranvera e vitit 2011 shënon fillimin e shndërrimit në realitet të ëndrrës së miliona e miliona udhëtarëve për ndërtimin e tunelit të Kërrabës që shkurton së paku 50 minuta distancën e Tiranës me El-

basanin dhe de fakto e bën Elbasanin qytetin më të afërt me Tiranën. "Shpreh kënaqësinë e madhe se kjo pranverë e vitit 2011, në datën 29 prill shënon fillimin e shndërrimit në realitet të ëndrrës së miliona e miliona udhëtarëve, të cilët të nisur drejt Tiranës, gjënë e parë që kanë imagjinuar, para se të ngjiteshin në majën e Kërrabës, ka qene një tunel për të arritur në kohën më të shkurtër në kryeqytetin e vendit. Kjo ëndërr fisnike e njeriut nis sot në këtë ceremoni shndërrimin e saj në realitet, në një hark kohor 18 mujor.

(vijon në faqen 6)



**Petrit Shuli, mokrari që synon
Këshillin Bashkiak të Pogradecit**

**PETRIT SHULI, KANDIDAT PËR ANËTAR
KËSHILLI NË BASHKINË POGRADEC
PARTIA ALEANCA PËR DEMOKRACI DHE
SOLIDARITET (ADS) - NUMRI 19**

19

**ARTAN SHKËMBI: "DERI
SA TË KEM JETË DO T'I
SHËRBEJ QYTETIT ME TË
GJITHA FUQITË E MIA
MENDORE E FIZIKE"**



**Topciu: Do t'u
kthej Pogradecin
qytetarëve**

*Feim Jashallari: "Kandidoj që
Trebinja të jetë komuna
më e zhvilluar
e Qarkut të Korçës"*

"PËRROI I XHA FER BEUT"

XHEVAIR SHTUPA

Petrit Shuli, mokrari që synon Këshillin Bashkiak të Pogradecit

**PETRIT SHULI, KANDIDAT PËR ANËTAR KËSHILLI NË BASHKINË POGRADEC
PARTIA ALEANCA PËR DEMOKRACI DHE SOLIDARITET (ADS) - NUMRI 19**

Petrit Selman Shuli, lindur në Pogradec më 27 Mars 1964 dhe me banim në Pogradec ka mbaruar shkollën e mesme në vitin 1983 dhe më pas vazhdoi studimet e larta në shkollën ushtarake në Tiranë, të cilat i përfundon në vitin 1986.

Aktualisht është në vazhdim të fakultetit ekonomik, në degën Administrim biznes.

Petrit Shuli rrjedh nga një familje e thjeshtë, shumë e nderuar mokrari. Babai i tij, Selman Shuli, i lindur dhe rritur në Velçan të Mokrës, ka qene një zotëri shume i nderuar dhe i respektuar në Mokër por dhe më gjerë, kudo ku ka punuar dhe jetuar. Për këtë Petriti është shumë krenar dhe asnjëherë nuk e ka harruar, apo mohuar origjinën e vet.

Eshte i martuar me znj. Mimoza Shuli, e cila është lindur dhe është rritur në Pogradec.

Ka mbaruar studimet e larta për administrim biznes, është e angazhuar me Shoqërinë Civile, ku është anëtare e bordit të Shoqatës së Grave Afariste në Shqipëri, drejton disa organizata jofitimpruese në Pogradec, ka mbaruar kursin njëvjeçar për diplomaci pranë Institutit Demokratik Amerikan, është një biznesmene e sukseshme, për të cilën është çertifikuar nga komisioni Europian në Bruksel, si Ambasadore biznesi nga Shqipëria. Aktualisht drejton një shoqëri kursim -kredie në Pogradec, pjesëmarrëse në disa konferenca ndërkombetare për sipërmarrjen femërore dhe fuqizimin e grave. Gjithashtu Mimoza ka dhënë një kontribut të madh dhe në punësimin e grave dhe vajzave te këtij qyteti.

Petriti dhe Mimoza kane dy fëmijë: një djalë qe ka mbaruar studimet ne degën inxhinieri ndërtimi, dhe një vajze që është në vitin e trete të shkollës së mesme "Nehemija".

Petriti për 6 vjet ka punuar si specialist pranë ndërmarrjes bujqësore në Pogradec. Me ndryshimin e sistemit përkrahu lëvizjen demokratike, duke dhënë një kontribut dhe angazhim te madh ne kete ndërmarrje me sindikatat kundër atij sistemi. Ne vitin 1994 fillon aktivitet privat me një lokal përballë turizmit. Gjatë punës së palodhur ne biznesin e



Voto Nr. 19

ALEANCA PER DEMOKRACI DHE SOLIDARITET (ADS)

tij për disa vjet arrin dhe ndërton një hotel ne vitin 2004 dhe sot Hotel "Perla."

Gjithmonë ka patur sukses ne biznesin e tij, duke pritur e

përcjellë miq dhe dashamires nga i gjithë vendi. Ka punësuar të paktën 10 persona, pra ndihmon ne 10 familje, nga keta 7 jane kryefamiljare. Biznesi ne hoteleri tur-

izëm e ka bere shume te njohur dhe me një rreth shoqëror te zgjeruar në gjithë vendin por dhe me gjere. "Ka ardhur momenti, - thote ai, - të zgjeroj

biznesin, mbasi kam shumë kërkesa për hotel, kërkesa këto që së vijnë dhe shtohen". Por ajo qe është e rëndësishme mbetet punësimi i 30 personave ne biznesin e tij ne vitet ne vazhdim mbasi te përfundoje investimin, dhe kjo është një mundësi shume e mire punësimi.

Petriti është anëtar i shoqatës mokrari "Pelioni" dhe ka sponsorizuar këtë shoqate dhe gazetën e vet dhe mendon qe te sponsorizojë dhe ne te ardhmen me qellim qe te ndihet fuqishëm zëri i Mokrës. Nuk është Mokra një vend ku mikpritja dhe butësia mokrari bën që qevirarët të marrin votat dhe te largohen, dhe mos kujtohen për të bërë gjë për Mokrën dhe qytetin. Vet mokraret meritojnë më shumë, jo vetëm fjale por me shume vepra, sepse Mokra ka shume njerëz të përgatitur, me shume kapacitete për t'u përfaqësuar denjësisht ne qeverisjen vendore, por dhe qendrore, Mokra duhet te nxjerrë deputetë djemtë që ka rritur dhe edukuar vete mbasi ata dinë më mirë hallet e fshatit dhe qytetit të tyre dhe dinë si t'i zgjidhin ato.

Duke qenë i sukseshëm në biznesin e vet Petriti mendon që me këtë experience të kontribuojë në vendimarrjet e këshillit bashkiak që kanë të bëjnë me biznesin dhe turizmin në përgjithësi. Ju bëjmë thirrje të gjithë dashamirësve të Mokrës që banojnë në qytet dhe të gjithë shoqërisë dhe miqve tanë **Votoni Petrit Shulin**, djalin me origjine nga Mokra për t'iu përfaqësuar ju denjësisht në këshillin bashkiak për të qenë një zë i fuqishëm dhe për të ndikuar në zgjidhjen e problemeve tuaja.

Nr.	Njesia vendore	QV	Zgjedhes	Vende ne keshill
1	BASHKIA POGRADEC	28	29751	25
2	KOMUNA BUCIMAS	15	11282	17
3	KOMUNA CERRAVE	11	7036	15
4	KOMUNA DARDHAS	8	2440	13
5	KOMUNA HUDENISHT	9	5320	15
6	KOMUNA PROPTISHT	13	4680	15
7	KOMUNA TREBINJE	9	2457	13
8	KOMUNA VELCAN	9	2528	13
Sum		8	102	65494

Flet Feim Jashallari, kandidati për kryetar komune në Trebinjë i "Aleancës për Qytetarin"

"Kandidoj që Trebinja të jetë komuna më e zhvilluar e Qarkut të Korçës"

Trebinja është një nga zonat më të bukura", nis të na tregojë kandidati për kryetar komune në këtë zonë, Feim Jashallari, i mbështetur nga "Aleanca për Qytetarin". "Kësaj komune, vijon ai, nuk i mungon asgjë, për sa u përket pasurive që i ka dhuruar natyra. Ajo ka thesare të vërteta dhe të shumta natyrore, pamje të mrekullueshme, vlera kulturore dhe historike, klimë të përshtatshme dhe kurative për vizitorët dhe turistët. Ka gjithçka. Mjafton që këto thesare të shndërrohen në vlera për banorët, dhe atëherë jeta e çdo familje do të jetë krejt ndryshe, cilësia e jetës do të jetë më e mirë, të ardhurat e tyre do të jenë më të larta. Të gjitha mundësitë ekzistojnë. Pikërisht këtë gjë dëshiroj të realizoj së bashku me komunitetin e kësaj komune dhe sigurisht që do t'ia dalim mbanë. Ndjej që kam mbështetjen e tyre dhe nuk kam asnjë dyshim që do të jem kryetar i komunës Trebinjë.

Tashmë ju keni 6 muaj në krye të kësaj komune, cila ka qenë eksperiencia juaj?

Po, drejtimin e kësaj komune e kam marrë 6 muaj më parë, në fund të muajit tetor të vitit të kaluar. Ndodhi kështu për shkak të zgjedhjeve të parakohshme që u zhvilluan në Trebinjë. Fitova dhe kandidimi im tregoi se koalicioni qeverisës tashmë do të ishte fitues në gjithë Shqipërinë. Kandidimin e prita me kënaqësi, por dhe me përgjegjësi. Tashmë kisha rastin të vihesh në shërbim të banorëve, të realizoja ato që kisha ëndërruar për zonën ku kisha lindur. Nuk doja që të më ikte humbur qoftë edhe një ditë, sepse në atë komunë të lënë jashtë vëmendjes për vite me radhë, duhej punuar me këmbëngulje dhe përkushtim, sepse mjaft kohë është humbur. Gjithsesi e kisha një shqetësim. Unë erdha në krye të komunës më 24 tetor, ndërsa dimri kish të filluar të afrohej. I ftohti dhe dëborë do të mbulonte gjithçka, mundësia për të investuar ose do të ishte e vogël, ose pamundur. Gjendësia përballë një sfide të madhe. I kisha vënë vetes dhe stafit tim së paku katër objektiva, për rrugë dhe ndriçime të fshatrave, dhe nuk do të dëshiroja që ato të mbeteshin të parrealizuara. Ata që më votuan, më kishin besuar dhe prisnin që të niste ndryshimi. Nuk doja t'i zhgënjehja, sepse unë dëshiroj të mbetem gjithnjë përkrah banorëve të mi.

Meqenëse u zgjodhët në kohën e dimrit, me këtë kërkoni të justifikoheni?

Nuk kërkoj të justifikohem aspak, përkundrazi. Sot mund t'u them me mjaft kënaqësi se premtime të deklaruara munda t'i kthej në realitet. Kjo gjë dukej e pabesueshme dhe për vetë banorët. Kur premtova ndriçimin me drita neoni, pati nga ata që u treguan skeptikë, madje i konsideruan si "premtime luks" dhe nuk dëshironin t'i besonin, por ja që ne i realizuam ato objektiva që i vumë vetes. Tashmë u them banorëve të kësaj komune se në harkun kohor të katër viteve që vijnë, Trebinja do të jetë një nga komunat më të zhvilluara të qarkut. E them këtë sepse kam një strategji të hartuar nga specialistët,



kemi projekte të përgatitura, kemi siguruar fonde për implementimin e tyre dhe nuk do të na mungojë ndihma nga qeveria qendrore. Veç kësaj do të hartojmë projekte për tërheqje fondesh dhe nga donatorë të tjerë. Gjithçka është e mundur, sepse projektet tona do të jenë të hartuara mbi vlerat reale që ka sot Trebinja. Sigurisht, gjatë punës time kam pasur edhe mbështetjen e zëvendëskryeministrit Haxhinasto dhe ndihmën e deputetit Bardhi Kadilli. Mbi të gjitha kam mbështetjen e komunitetit tim. Që të gjitha këto më bëjnë të ndihem mirë dhe të jem i sigurt për të ardhmen e Trebinjës. Objektivi im i vetëm është: një Trebinjë me zhvillim ekonomik të përparuar. Dhe këtë do ta realizojmë brenda katër viteve që vijnë.

Cilat janë problemet me të cilat përballlet sot Trebinja?

Ne kemi evidentuar të gjitha problemet me të cilat përballlet çdo familje e Trebinjës. Aktualisht fshatrave të kësaj komune i mungojnë ujësjellësit, i mungojnë shkollat, nuk ka qendra shëndetësore, vuan nga mungesa e rrugëve, nuk është menduar për ndriçimin. Komuna përballlet me varfërinë, banorët jetojnë me asistencë sociale. Biznesit nuk i janë krijuar kushte për të ecur përpara, nuk kanë ekzistuar mundësia për lindjen e iniciativave nga vetë banorët. Bujqësia ka mbetur jashtë vëmendjes. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për blegtorinë, edhe për rritjen e bletëve, por edhe për aktivitete të tjera prodhuese. Dhe sikur të mos mjaftonin këto, njihesh edhe me një realitet tjetër të hidhur: jeta e të rinjve nuk ka larmi, i mungojnë aktivitetet rinore dhe e gjitha kjo situatë krijohet nga mungesa e kushteve për argëtim, aktivitete sportive dhe kulturore. Kur njihesh me këtë realitet, nuk ndihesh mirë. Megjithatë, fajin nuk do ta kërkojmë kurrkund. Përkundrazi gjetjes së fajtorëve, ne do të punojmë për zgjidhjen e problemeve.

Cilat janë projektet tuaja për katër vitet e ardhshme?

Projektet tona për të ardhmen e Trebinjës janë të shumta dhe të gjitha këto do t'i realizojmë me dëshirë dhe zemër. Megjithatë, ne mund të renditim me këtë rast projektet tona më të rëndësishme që do të zbatohen së shpejti dhe brenda harkut kohor të katër viteve. Në dt 25 do të fillojë ndërtimi i rrugës së Dunicës me 140 milionë lekë, e cila do të jetë një nga rrugët më të mira të kësaj zone. Mund të them gjithashtu se fillimi i kësaj rruge shënon dhe investimin e parë në të gjitha komunat e qarkut Korçë. Kjo do të thotë që e kemi nisur mbarë, sepse kemi punuar për të qenë të parët. Kur erdha në krye të komunës, shkollën e Trebinjës e gjeta në gjendje tejet të mjerueshme. Më erdhi keq për këtë gjë, sepse në këtë shkollë të mesme janë shkolluar shumë nxënës të kësaj zone, shumë prej tyre sot kanë emrin e një intelektualit të njohur apo të një specialisti të aftë. Dhe jo vetëm për arsye nostalgjive, por që fëmijët tanë të studiojnë në kushte mira, sipas standardeve, ne që në vitin e parë të këtij mandati do t'i japim Trebinjës shkollën që meriton, sepse do ta rikonstruktujmë plotësisht. Megjithatë, rikonstruksioni i shkollës së Trebinjës nuk do të jetë i vetmi. Në të njëjtën kohë do të vijojmë edhe me rikonstruksionin e shkollës së Podgozhanit. Aktualisht kemi siguruar fondet për të dy shkollat. Ndërkohë jemi duke përfunduar projektin për shkollën e Selcës së Sipërme. Ndërsa brenda 2 viteve të mandatit tim, njerëzit e kësaj zone do të kenë mundësinë të qarkullojnë nga Dunica deri në Prezhishtë përmes një rruge të parametrave evropiane. Kjo rrugë përfshin një ndër projektet tona më madhore, pasi ky projekt ka qenë një nga kërkesat më imediate të të gjithë banorëve, por që deri më tani nuk e kishin parë të konkretizuar. Sigurisht që është një zotim i madh, por do të jetë i realizueshëm, sepse projekti ka përfunduar, ndërsa vitin e dytë, kjo arterie e rëndësishme e komunës Trebinjë do të jetë e realizuar. Brenda mandatit tim të parë do të ndërtohen një sërë ujësjellësish, me qëllim që të gjitha fshatrat të kenë ujë të pijshëm. Edhe ky zotim do të shndërrohet në realitet, sepse edhe për këtë gjë, kemi projekte të përfunduara dhe të miratuara. Projekte të tilla kjo komunë nuk ka pasur rastin t'i njohë me parë, ndaj shumë prej banorëve ishin mosbesues në ndryshimet që mund të pësonte Trebinja. Megjithatë, ne nuk do të ndalemi këtu. Brenda vitit të parë të mandatit tim kjo zonë do të ketë dentistin e saj, ku të rinjtë deri në moshën 18 vjeç, këtë shërbim ta marrin falas. Këtë gjë e mundëson një vendim i qeverisë. Ndërsa në dy vitet e para të mandatit tim, çdo fshat i komunës Trebinjë do të ketë qendrën shëndetësore. Për të gjitha këto arsye, banorët do të fillojnë të menjohet ndryshe për jetën e tyre dhe do të kërkojnë më shumë nga drejtuesit e komunës.

Cili do të jetë programi juaj për zhvillimin ekonomik të zonës?
Programi ynë për zhvillimin

ekonomik të zonës konsiston së pari në zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, bletërritjes dhe përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale. Sigurisht për arritjen e këtij objektivi do të punojmë ngushtësisht me Drejtorinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me qëllim që të përfitojmë nga subvencionet shtetërore, kurse nga ana jonë do të krijohen të gjitha kushtet për ushtrimin e aktivitetit të tyre, qoftë bujqësor apo blegtoral. Ndërkohë do të mbështesim çdo fermer në të gjitha iniciativat e tyre për rritjen e prodhimit. Këto nuk do të ishin synimet tona të vetme, pasi siç e thashë që në fillim, Trebinja ka thesare të mëdha natyrore, të cilat duhen të shndërrohen në vlera për banorët. Në këto treva gjen mjaft objekte me rëndësi historike, mjaft pamje të mrekullueshme, të cilat mund t'i shndërrojmë në të vizitueshme për vizitorët dhe turistët. Sa më shpejt që të arrijmë në këtë objektivi, aq më të lehtë do ta kemi që këtë zonë ta shndërrojmë në një trevë të agroturizmit, ku çdo mundësi e saj të shfrytëzohet e të kthehet në të ardhura për vetë banorët. Madje kjo do të ishte nxitja më e mirë për shfrytëzimin e tokës bujqësore dhe rritjen e numrit të të imtave dhe gjedhit. Për herë të parë, ne do të hapim tregun javor për të gjitha prodhimet që vijnë nga gjithë hapësira e komunës, mund të them se do të jetë një panair i vërtetë, ku çdo banor i zonës do të përfitojë shumë prej tij. A do të mundemi vallë? Sigurisht që po, sepse në këtë sipërmarrje nuk jam i vetëm. Unë do të bashkëpunoj me çdo banor të komunës, me çdo intelektual të saj, me çdo specialist, vetëm e vetëm që Trebinja të marrë atë që meriton.

Çfarë keni projektuar për gjallërimin e jetës kulturore për të rinjtë?

Kur kam shpallur programin tim, për sa i përket jetës kulturore, sërish ka pasur njerëz që kanë qenë skeptik, por ato që do t'i realizojmë, sepse çdo premtim do të jetë i vërtetë. U kam premtuar të rinjve se në Trebinjën e largët do të ekzistojnë kalçetot më të mira të qarkut Korçës, dhe këtë do të nis ta bëj realitet. U kam premtuar se në fund të këtij viti do të arrijmë të ngremë ansamblin "Mokra e Sipërme" dhe këtë sërish do ta bëjmë realitet. U kam premtuar se në fund të këtij viti, Trebinja do të organizojë kampionatin "Mokra e Sipërme" dhe këtë gjë sërish do ta realizoj. U kam premtuar se skuadra që del fituese do të përfitojë 200 mijë lekë, dhe ky premtim do të jetë real. Pasi të kemi mbërritur në këtë pikë do të vijojmë me projekte të tjera, artistike dhe kulturore. Pa asnjë droje mund ta përsëris sërish, ne do ta shndërrojmë Trebinjën në komunën më të zhvilluar të qarkut Korçë, sepse natyra i ka dhuruar gjithçka. Ata që nuk besojnë le të na presim sa të fillojmë nga puna dhe shumë shpejt që të gjithë kemi për të punuar bashkë.

VEPROR HASANI
SKËNDËR DEMOLLI

Programi, objektivat e CW e kandidatit socialsit Artan Shkëmbi i "Aleanca për të Ardhmen"

"Deri sa të kem jetë do t'i shërbej qytetit me të gjitha fuqitë e mia mendore e fizike"

OBJEKTIVAT E REALIZUARA NË KËTO DY MANDATE :

1- Qytetin e gjeta me një liqen të ndotur totalisht, ku derdhja e ujërave në liqen kishte dëmtuar ndjeshëm jo vetëm florën dhe faunën e liqenit, por kishte bërë të pamundur notimin dhe plazhi i qytetit prej vitesh ishte i boshatisur. Ndërsa sot kam kënaqësinë të konstatoj se nuk ka asnjë derdhje të vetme, të ujërave të përdorura në liqen. Uji i pastër dhe plazhi i sistemuar kanë rikëthyer plazhistët e shumë nga vëndi dhe shumë turistë të huaj. Kjo falë ndërtimit të kolektorit të ri, impiantit modern të pastrimit si dhe rrjetit të ri të kanalizimeve, i cili është në fazën e tretë dhe të fundit, projekt i cili fillon së shpejti dhe është i financuar nga Banka Germane për Zhvillim KFW, që e ka bërë qytetin e parë në Shqipëri me impiant modern për trajtimin e ujërave të përdorura.

2- Qytetarët e qytetit tim, tashmë kanë vite që kanë hequr depozitat e ujit nga teracat e banesave dhe uji cilësor rrjedh pa ndërprerje në çezmat e tyre, uji me orar është një ëndër e keqe e haruar e para viteve 2004.

3- Për mëse 5 vite me rradhë qyteti i ngjan një kantieri të madh ndertimi, për shkak të realizimeve të dy projekteve madhore të përmendura më lart në ta cilat po punohet hap pas hapi për sistemimin e infrastrukturës rrugore të qytetit, tani me koncepte bashkë kohore, duke e shndëruar qytetin me një hapësirë rrugësh paqesh e shëtitorësh të denja për një qytet evropian e turistik. Bashkëqytetarët e mij, pas mirëkuptimit të dhënë për e krijuar nga punimet shumta, sot po shijojnë rezultatet e kësaj pune, sot me rrugë e trotuare të shtruara me pllaka dekorative, hapësira të gjelbëra shatërvane, bulevarde të gjërë e rrugë e rugica me kalldrëme guri ne lagjet e vjetëra tradicionale të qytetit, vepra arti monumentale Korifetje të letrave të kulturës shqiptare, Lasgush Poradeci dhe Mitrush Kuteli.

Sot në të gjithë gjatësinë e bregut të liqenit prej 2 km, parku dhe shëtitoria ofrojnë hapësira të gjelbëra me ambiente pushimi për moshat e treta, kënde lojnash për fëmijë dhe ambiente sportive për të rinjtë.

4- Sot qyteti ka Planin e Përgjithshëm Rregullues, Planin Strategjik të Zhvillimit e zotëron asete me vlerë që janë bazë për zhvillimin e qëndrueshëm të tija. Gjithëcka që ndodh në qytet është në përputhje të plotë me objektivat strategjike dhe strategjinë e zhvillimit të qytetit dhe rajonit.

5- Sistemimi i ambienteve të brëndëshme në lagje e blloqe bani është sot prioriteti i investimeve të Bashkisë. a-Rikonstruksioni i plotë i lagjes karakteristike Topleci, lagjen e Kishës, Shkollën e dytë shqipe, shtëpitë e vjerëra



* KUSH ËSHTË Z.ARTAN SHKËMBI?

Kam lindur në Pogradec, këtu mësova të eci, të flas e të notoj. Në këtë qytet u rrita, u shkollova e më pas krijova familjen time, linda e po rrit 4 fëmijët po me të njëjtën dashuri për qytetin tonë të bukur. Jam larguar nga qyteti vetëm për shkak të kryerjes të studimeve të mija universitare e pasuniversitare ku jam lauruar shkëlqyer në shkencat e sakta për matematicien. Kam kontribuar për pluralizmin në qytet dhe ka ushtuar detyra si edukator në fshat e qytet, deri në detyrën e shefit të seksionit të Arsimit të Rrethit . Kam përvojë e bashkëpunim pune me Kompani Bisnesi e Bankën Gjermane K.F.W e USAID , me Hollandën "Agrinasi" , Kompani Austriake e kompani bisnesi nga vëndet Perëndimore si dhe mardhënje e binjakëzime me Universitetin e Padovës në Itali, Qytetin e Verias në Greqi , qytetet e Ohërit , Strugës në Maqedoni , me Lidhjen e Artistëve në Qytetin e Prishtinës Kosovë si dhe shumë mardhënje bashkëpunimi me Turqinë e Malin e Zi. Jam i përzgjedhur Kryetar i Shoqatës së Kryebashkiakëve të Shqipërisë, post që mbahej nga Z. Edi Rama para se ai të ngarkohej me detyrën e Kryetarit të PS, detyrë shumë domethënëse !

VËND BANIMI I JUAJ!?

Do vazhdoj të jetoj në qytetin tim, mes njerëzve të thjeshtë e të dashur të tij, deri sa të kem jetë dhe do t'i shërbej qytetit me të gjitha fuqitë e mija mendore e fizike. Çdo pogradecar i mirë besoj se këto do bëjë së bashku duke mbështetur njëri tjetërin në të mirë e në nevojë. Ky është dhe pasioni më i madh që më ka udhëhequr në dy mandatet e mija e që më shtyn të kandidoj sërish për mandatin tim të tretë. Unë shpreh respekt dhe mirënjohje për besimin që më kanë dhënë dhe që do vazhdojnë të më japin bashkëqytetarët e mij, që pa dyshim është dhe frymëzimi im më i madh për punën time.

karakteristike dhe shtëpitë e lindjes së Lasgushit e Mitrushit, Rikonstruksionin e lagjes Kala, lagjes Nr 1, 2, 5, blloku Rinia, si dhe ndërhyrje e punime shumë të rëndësishme tek Lumin i Madh i qytetit duke bërë që të krijohet një tjetër mjedis fantastik perlë.

Përfundimi i fazës së tretë të punimeve në projektin e kanalizimeve të ujërave të përdorura, do ti hapë rrugë investimeve në lagjet e tjera periferike si kurëse është Blloku tek ish Ndërmarrjen Bujqësore, lagja Goricë tek

Gurorja apo lagja tek Përroi i Çaprazit. Financimet për këto ndërhyrje janë siguruar tashmë nga Prokredi Bank. Këto punime do realizohen gjatë 4 viteve të këtij mandati të ri dukë bërë që të përfundojë sistemimi i plotë i infrastrukturës në të gjitha pjesët e mbetura të qytetit, të cilat do bëjnë të mundur përmirësimin e ndjeshëm të cilësisë së jetës të qytetarëve tanë. Projektin e ri që filloi të zbatohet në mesin e muait prill, në bashkëpunim me Bankën Gjermane

KFW dhe USAID po bëjnë të mundur jo vetëm përmirësimin e sistemit të grumbullimit dhe pastrimit të mbetjeve urbane por dhe riciklimin e mbetjeve urbane si në cdo vënd të Evropës së qytetëruar. Duhet theksuar se ky Projekt pilot po zbatohet në qytetin tonë, fal besimit dhe mardhënjeve shumë korekte të Bashkisë gjatë realizimeve të projekteve të më parëshme me Bankës Gjermane KFW & USAID.

* PO KULTURA, ARTI DHE SPORTET?

Kultura, Arti e Sporti janë pjesë e pandarë e investimit shpirtëror krahas atij në infrastrukturë. Një qytet si Pogradeci, ofron aktivitete të veçanta dhe me shumë vlerë që jo vetëm mbajnë gjallë shpirtin artist e kulturëdashës, por nxisin natyrshëm zhvillimin e turizmit kulturor e sportiv në të katër stinët. Sot qyteti ka kine-manë e tij publike në shërbim të qytetarëve. Sot Pogradeci ka Galerinë e Arteve Figurative, aq të dëshiruar dhe të merituar për piktorët e fotografët e shquar pogradecarë e nga gjithë Shqipëria e ka cila shërben për hapjen e dhjetra ekspozitave kombëre dhe ndërkombëtare nga autorë vëndas e të huaj që e ka bërë këtë Galeri shumë atraktive dhe të vizituar nga qytetarët e pushuesit e shumë si rrallë ndonjë Galeti tjetër në vënd, kjo falë dhe drejtimit të kësaj Galerie nga "Piktori i merituar" Anastas Kostandini, një personalitet i shquar i artit figurativ shqiptar, i cili mbase mund të thuhet se përligj me së miri një thënjë latine "Qytetin e mbrojnë dhe e lartësojnë burrat jo muret". E them këtë se kjo Galeri i kalon përmasat e saja, ajo shërben si një. Dhomë e madhe pritej për gjithë qytetin e qytetarët e tij të cilët këtu mbledhen e nderojnë e respektojnë jetën e veprën e shumë bashkë qytetarëve të vlerësuar, "Nderi i Qytetit a Nderi i Kombit". apo festime data lindjesh e mik pritej personalitete të vëndit a nga vëndet të huaja.

*Pogradeci ka Teatrin e Kukulave që nxit dhe promovon teatrin mbarë kombëtar dhe evropian që organizohet për herë të 10 dhjetë. Unë personalisht ndjehem i nderuar që jam themeluesi dhe Presidenti i këtij Festivali që nga nga dita e themelimit. Prej dy vjet tashmë Pogradeci ka Grupin artistik të këngës qytetare "Nostaligia" i iniciuar organizuar e financuar nga Bashkia me synim rruajtia e vlerave e pasurimin e këngës qytetare pogradecare e rrethinave.

Këto ditë u përurua Fanfara e qytetit e munguar prej më se 20 vitesh. Qytetit i është kthyer Muzeu i qytetit i munguar prej 15 vjetësh. Biblioteka e qytetit ofron shërbime cilësore për lexues të rritur dhe nxënësit e shkollave për cdo ditë të javës.

*Sot qyteti ka ata që i ka munguar në gjithë historinë e tija : Dy monumentet madhështorë që ngrihen në qëndër të qytetit Lasgush Poradeci dhe Mitrush Kutelin, dy kolosë të letrave që do t'i kishte zili çdo qytet në botë. Për të cilat pa asnjë modesti, ndjehem i përkëdheluri i fatit dhe krenar deri në pafundësi që jam autori i realizimit dhe financimit të këtyre Monumenteve që do qëndrojnë në shekuj, brez pas brezash në memorjen e cdo pogradecari.

*Aktivitete pa fund janë organizuar në qytet në këto vite. Monodrama e spektakle, koncerte e parade mode, ekspozita e prezantime, promovime e montazhe artistike, misse e koncerte sinfonike. Masivizimi i aktiviteteve e ka këthyer qytetin në një qytet plot gjallëri e atmosferë festive ku doemos duhet vecuar Festën tashmë tradicionale prej disa vitesh vetëm të qytetit tonë atë "Të hapjes së Kanelave të Buteve e të të bërit të qejfit tamam "I si dhe të "Dhëndurëve që ju betoheshin zonjave" Se nuk e pinë, Verën e Rakinë "

*Sporti është pa dyshim në zëmërën e cdo të riu pogradecar që vazhdon të dashurojë, volej bollin e basketbollin në ambientet e krijuara rishtazi në këndin sportiv bashkëkohor. Çiklizmi i ringjallur i kampionit kombëtar të dikurëshëm, pogradecari Piro Simon Anzhele.

Kanotazhi po starton gjallërimin e sporteve të ujit me shpresën e masivizimit të tija

*E pa dyshim që Futboli është ai që mban gjallë zëmërat e mijëra tifozëve të zjarr që mbas 19 vitesh e shohin ekipin e tyre të zëmërs dikur të quajtur "Dragoi", "Ylli i Kuq", sot ai të jetë në Superligë dhe Kampion i Kategorisë së Parë. Mee ambiente moderne të fushës stërvitore e stadiumit, të dyja të restauruara me financim të Bashkisë dhe F S F janë këto tashmë arena ku do zhvillojnë ndeshjet kampionë e vitit 2011 që do festojnë hyrjen në super ligë javën e parë të muajit maj 2011 !

Investimet në infrastrukturë, shërbimet e shumëta të përditëshme, mbështetja e bisnesit të vogël e të madh, komunitetin e artistëve dhe gjithë shtresave në nevojë kanë qënë e do jenë në fokus të qeverisjes sime vendore.

Nuk e tepëroj se mua më njohin 100 përqind e qytetit dhe unë njoh mbi 90 përqind të tyre, gjë që nuk ndodh me kandidatin tjetër r zotin Luan Topciu. Për ta mbyllur me dy tregues sinifikativë mendoj. Po përmend vetëm një nga indikatorët e shumë të progresit : Nga rreth 10.000 mijë netë shtretër të regjistruara në verën e vitit 2004 sot ne numurojmë 120.000 mijë netë shtretër në sezonin veror 2010 dhe xhiro të dyfishuar në bisneset e konsumit të përditëshëm.

KOÇO PIHONI

Topçiu: Do t'u kthej Pogradecin qytetarëve

Luan Topçiu përfaqëson koalicionin e djathtë në zgjedhjet vendore për bashkinë e Pogradecit. I mbështetur nga LSI dhe PD, ai synon që të fitojë ndaj kreut aktual të bashkisë, Artan Shkëmbi. Topçiu rrëfen në një intervistë për Shekullin projektet e tij për qytetin e Pogradecit: Programi im dhe i ekipit tim është një shans i ri për një zhvillim cilësor të qytetit të Pogradecit, të kapluar nga varfëria dhe papunësia, nga pluhuri dhe balta.

Zoti Topçiu, ju kandidoni për bashkinë e Pogradecit përse duhet t'ju votojnë ju dhe jo kandidatin tjetër

Kandidimi im për bashkinë e Pogradecit është një ofertë elektorale me një program real zhvillimi, me një vizion për katër vitet që vijnë dhe një skicim për 30-40 vitet që vijnë. Idetë e mia për zhvillimin janë përmbledhje e ëndrrave të qytetarëve tanë për një qytet më të mirë.

Programi im dhe i ekipit tim është një shans i ri për një zhvillim cilësor të qytetit të Pogradecit, të kapluar nga varfëria dhe papunësia, nga pluhuri dhe balta, nga mungesa e vizionit. Kandidati tjetër, që është në largim nga posti i tij, dëshmoi shterpësi në ide, investime të përsëritura në disa rrugë dhe më shumë se gjysma e qytetit në harim, i mbytur nga balta, pluhuri dhe nga mungesa e kujdesit të Bashkisë.

Qytetarët e mi nuk mund të pranojnë që të jetojnë në një nga qytetet më të varfra të rajonit dhe të kenë kryetarin e Bashkisë më të pasur. Ajo që mund të thuhet me pak fjalë është rezultati mediokër në drejtimin e qytetit. Ajo që është më e rënda është falimentimi i Bashkisë së Pogradecit, duke mos paguar firmat kontraktuese që kanë punuar në qytet, duke thëlluar borxhet e Bashkisë, duke humbur sasi të mëdha parash nga gjyqet me subjekte që kanë hedhur në gjyq Bashkinë.

Cila është pika me e dobët e kundërshtarit tuaj?

Autoritarizëm, korrupsion dhe mungesë vizioni. Ky është perceptimi i gjerë qytetar që e përkuqizon z. Shkëmbi si mbartës i një modeli oriental në qeverisjen vendore. Dhuna dhe të konceptuarit të qytetit si çiflig, për çdo qytetar ngjall krupë. Një njeri që nuk pranon të jetë i barabartë në konkurrim.

Prej panikut ka mbushur hapësirat publicitare në masën 80%, duke qenë gati të dhunojë çdo poster, çdo material publicitar, çdo simbol partish. Kur mendon që këtë e bën një njeri që ka ushtruar detyrën e kryetarit të Bashkisë për dy mandate tregojnë qartë që Shkëmbi është në gjendje thërrmimi psikik. Shenja e qartë e humbjes dhe e largimit nga "bajraku" e bëjnë më të dhunshëm. Qeverisja e re vendore do të forcojë besimin e humbur të qytetarëve tek Bashkia. Sistemi i ri vlerash, punonjësit të aftë dhe të përgjegjshëm, respektim padiskriminim të taksapaguesit pogradecarë. Kemi marrë përsipër misionin e modernizimit dhe rritjes së kredibilitetit të shtetit. Në zyrat e administratës shtetërore, qytetari do të respektohet pa diskriminim, dhe se barazia e shanseve



duhet të jetë një vlerë e pamohueshme.

Cili është plani juaj për te drejtuar bashkinë katër vitet e ardhshme?

Punësimi dhe zhvillimi ekonomik janë prioriteti i luftës sime si kryebashkiak. Me besim marr këtë përgjegjësi në kohë të vështira. Do mposhtim varfërinë me investime dhe punësim. Qëllimi i programit tonë qeverisës është kalimi nga faza e mbijetesës në atë të mirëqenies.

Kemi politika konkrete për promovimin konstant e progresiv të potencialit ekonomik, intelektual dhe gjeostrategjik të pashfrytëzuara të Pogradecit. Do luftojmë për thithje të investimeve direkt nga biznesi pogradecar, kombëtar dhe ndërkombëtar, do të vendosim një bashkëpunim të ngushtë me qeverinë shqiptare, do të luftojmë për rritje të cilësisë dhe sasisë së shërbimeve - për të siguruar një pozicionim strategjik.

Cili është projekti më i rëndësishëm që ju i premtoni qytetarëve?

Problemi kryesor që shtrohet sot në Pogradec është pakësimi i hapësirave publike dhe shtimi i hapësirave private. Bashkia ka detyrimin e shtimit të hapësirave publike dhe ndalimin e dhunimit të atyre publike. Urbanizmi dhe arkitektura konsiderohen shpirti artistik i një komuniteti dhe një pasuri që siguron të ardhura konstante për Pogradec

cin e sotshëm dhe atë të brezave që vijnë. Do frenojmë shkatërrimin urban dhe arkitekturor. Ndërtimet në një qytet turistik, detyrimisht duhet të plotësojnë dhe kriterin estetik. Çdo fasadë, çdo trotuar, çdo rrugë e stolisur nga pikëpamja urbane, çdo peme, çdo lule e mbjellë në qytet e bën qytetin më tërheqës. Do të krijojmë fytyrën e një qyteti evropian, duke ruajtur gjithçka që trashëgojmë nga kultura e të parëve tanë.

Çfarë u premtoni bizneseve?

Biznesmenëve iu premtojmë luftë ndaj informalitetit dhe korrupsionit. Biznesmenët duhet të kenë një klimë të favorshme për zhvillimin e bizneseve të tyre, shanse të barabarta konkurrimi, taksa të ulëta që të dalin me bizneset e tyre nga informaliteti. Bashkia do të hartojë plane zhvillimi për biznesin e vogël dhe të mesëm. Dy janë komponentët me të fuqishëm të një qyteti: Bashkia dhe biznesi elitari i qytetit.

Komuniteti i biznesit kërkon nga qeverisja lokale të përbushin synimet e dëshiruara. Çfarë duhet ta bëjë Bashkinë e Pogradecit efektive, nuk është makineria formale qeverisëse, por partneriteti me biznesin. Partneriteti do të thotë bashkëpunim dhe jo kontroll. Ne duhet të mësojmë të punojmë së bashku për të arritur qëllime reciproke. Aktet e deritanishme kanë qenë vetëm veprime simbolike se Bashkia po bën

diçka për ekonominë e Pogradecit.

Cila është politika juaj për taksat vendore?

Premtim për seriozitet fiskal dhe për rigjallërim ekonomik. Pogradeci ka nevojë për lehtësira tatimore dhe subvencionime për tokën dhe kreditë. Ka nevojë për investime në qendra sociale dhe sportive. Ka nevojë për rinovimin dhe rigjallërimin e bregut të liqenit.

Si do te menaxhoni çështjen e plehrave të qytetit?

Çështja e plehrave të qytetit mbetet një problem madhor që kërkon zgjidhje. Ka zona në qytet që janë të mbytura nga plehrat, ka zona të tëra që kanë kazanin e plehrave për disa kilometra larg, plehra që kanë mbushur lumin e qytetit. Do të përdorim përvojën më të mirë evropiane për menaxhimin e plehrave.

Fakti që Pogradeci është një qytet turistik, fakti që ne pretendojmë të jemi një qytet ekologjik dhe i pastër, kërkon që ky problem të jetë një prioritet i politikave tona si bashki.

A mendoni se pushteti lokal i ka mjetet e duhura për te realizuar këto premtime?

Padyshim që të gjitha premtimet elektorale janë të mundshme. Po të mendojmë që mbi 20.000 metra linearë rrugë janë të pashtruara në qytet dhe vetëm në 6 vitet e fundit janë harxhuar 250.000.000 lekë të reja, që po të ishin harxhuar si duhet të kishim një qytet të gjithin të asfaltuar.

Në vitin 2009 për pastrimin e qytetit janë 35.314.000 lekë të reja. Por mund të përfitohen grante nga Qeveria Shqiptare dhe fonde komunitare apo duke bërë projekte të përbashkëta për një eurozonë, bashkë me qytetet e tjera kufitare si Struga dhe Ohri.

Si e cilësoni nivelin e kriminalitetit në qytetin tuaj?

Fatkeqësisht ka shtim të rasteve të dhunës në qytet. Punësimi dhe hapja e universitetit në qytet, emancipimi dhe kultura do të jenë faktorë të qetësisë publike. Pogradeci është një qytet që shquhet për qetësinë e tij qytetare, për tolerancën, për shpirtin e butë dhe dashurinë për të bukurën. Politikat për të zhvilluar kapitale sociale do të zbusin fenomenet e shkeljes së ligjit dhe kriminalitetit.

Si do ta përmirësoni infrastrukturën rrugore në shërbim të turizmit?

Është një situatë e rëndë e infrastrukturës së rrugëve në qytetin e Pogradecit. Kthimi i tyre në gjendje normale, asfaltimi, trotuare, ndriçim dhe gjelbërim do të normalizojnë peizazhin urban, do të ulin ndotjen e ajrit në qytet, do të lehtësojnë jetën e qytetarëve. Pas ndërhyrjes për rrjetin e kanalizimit të qytetit janë shumë rrugë të paasfaltuara dhe mjaft probleme të pazgjidhura për shkak të indiferencës së autoriteteve lokale. Do të përdoren të gjitha mundësitë për të gjetur zgjidhjet optimale për të urbanizuar zona që nuk e kanë ndjerë asnjëherë dorën e Bashkisë së qytetit dhe në radhë të parë ndërtimin e rrugëve.

Thirrja e fundit e kandidatëve

ILIA MANI



* Rikonstrukcioni i ujësjellsave për fshatrat Bishnicë – Velçan dhe ndërtimi i linjës së re Laktesh

* Kalimi dhe sistemimi i rrugës kryesore Proptisht- Losnik- Velçan, Laktesh – Velçan – Buzaishtë- Bishnicë

* Vazhdim i rikonstrukcionit të shkollave në Bishnicë, Buzaishtë, Senisht

* Vazhdim i projektit të përmirësimit të pyllit (mbjellje, ricungim, rrallim).

Do të lidhet me rrugë çdo familje në të 8 fshatrat: Velçani, që është në përfundim, do të vazhdojë në Laktesh, Buzaishtë, Bishnicë, Losnik, Shpellë, Jollë. Do të ketë 2 qendra shëndetësore, në Bishnicë, Shpellë e Jollë, sistemi i rrugës Bishnicë - Shpellë- Jollë. Kemi ndërtuar një qender shëndetësore në Losnik me një vlerë prej 10mil lekë të vjetra

Falë edhe përvojës për 3 vjet si kyeplak në Velçan dhe 4 vjet si kryetar komune, në një përvojë që u mungon fare knudërshtarëve të mi politikë, do të arrij që edhe për katër vitet e ardhshme të jem sa më pranë halleve dhe nevojave të bashkëfshatarëve të mi. Le të vijojmë së bashku, Velçan!

FUAT FERRO

“Ka ardhur koha t’i themi “Stop” kërcënimeve me kafshatën e gojës.....dhe t’i themi “Mjaft”, gjithçkaje që na pengon të ecim përpara. Mjaft duam 8 vite në varfëri, pa rrugë, ujë dhe pa punë, të kerrusur prej mashtrimeve, gënjeshtërave e kërcënimeve! T’i themi “Stop” njëherë e përgjithmone asgjësë që s’di të beje gjë tjetër vejëse asgjë!...”




SALI TORRA

Ne themi të bëjmë për ju...

- 1.Sistemim, asfaltim rruge Proptisht - Laktesh - Velçan - Bishnicë
- 2.Ujësjellësi Bishnicë - Velçan
- 3.Rikonstrukcioni i shkollës Bishnicë
- 4.Sistemi i ujitjes Buzaishtë - Velçan - Laktesh
- 5.Sistemi i rrugës Auto Qafë Kurrizve - Senisht
- 6.Sistemi i rrugës Velçan - Losnik
- 7.Subvencioni i fermerëve
- 8.Sistemimi i rrugës Shpellë

Roshi premton se do të këtë ujë të pijshëm në të gjitha fshatrat dhe asfalti nuk do të mungojë në asnjë cep të fshatrave.

Do të përfundojë ndricimi i rrugëve, do të rregullohen ujrat e zeza dhe të gjitha fshatrat do të jenë me pastërti maksimale. Pasi të ketë fituar këto zgjedhje dhuratat do të jenë: në fshatin e Tushemishtit do të ndërtojë 1 shatërvan madhështor dhe në Bucimas do të ndërtohet 1 sahat 24 m i lartë.



(vijon nga faqja 1)

Autostrada Tiranë – Elbasan, me tunelin e Kërrabës, përbën pas rrugës së kombin, veprën e dytë më të madhe publike që ndërtohet në historinë e kombit shqiptar. Kjo autostradë prej 31.7 km, me një tunel 2.4 km të gjatë, 21 viadukte, 7 mbikalime, 4 nënkalime, shpejtësi lëvizjeje 120 km në orë, shkurton së paku 50 minuta distancën e Tiranës me Elbasanin, shkurton në 2/3 këtë distancë dhe de fakto e bën Elbasanin qytetin më të afërt me Tiranën. Autostrada mbi-përgjysmon distancën e qarqeve të tjera, veçanërisht Korçës, rretheve të tjera të Elbasanit, Dumresë dhe së shpejti dhe Beratit, me kryeqytetin e vendit. Autostrada, duke iu referuar gjësë më të çmuar që ka njeriu, kohën, i dhuron një kohë çdo qytetari, çdo udhëtar. Autostrada Tirane- Elbasan krijon rajonin më të madh të tregut në Shqipëri dhe ndër më të mëdhenjtë në rajon. Punimet për këtë autostradë do të realizohen nga Kompania e njohur greke AKTOR dhe parashikohet të përfundojnë brenda 18 muajve.

Mokra, tani edhe më afër

Parametrat kryesore të rrugës:
Gjatësia e Autostradës: 31.17 km
Afati i punimeve – 18 muaj nga dita e fillimit
Distanca Tiranë-Elbasan: 18 minuta

Segmenti: Tiranë – Lundër – Mullet – Elbasan
Tunel- 2
Gjatësia e tunelit: 2.3 km dhe 2.1 km
Gjatësia totale e tunelit për të dy tubat - 4.3 km
Shpejtësia e lëvizjes së automjeteve - 100-120 km/h

Autostrada - 4 korsi
Korsi emergjence - 1
Gjerësia e një vije kalimi - 3.75 m
Gjatësia e rrugës në mbushje - 18.5 km
Gjatësia e rrugës në gërmim - 17.4 km
Gjatësia totale e viadukteve - 4.65 km
Numri i mbikalimeve - 7
Numri i nënkalimeve - 4
Numri i viadukteve - 21
Numri i kryqëzimeve në disnivel - 3



“PËRROI I XHAFER BEUT”

(Kujtimit të gjyshit tim Beqar Shtupa që i donte shumë miqtë, por i falej veç Perëndisë e Punës)

XHEVAIR SHTUPA

Përroi me këtë emër është në hyrje të fshatit Homçan, në krahinën e Mokrës, nga ana veri – perëndimore e tij. Përroi pret rrugën kryesore të fshatit në hyrje që nga Propitshiti. Homçani ka shumë përrën timer që sjellin ujë për të vaditur kofshtrat e arat dhe marrin tatëpjete plirat e i shpien në lumë. I shtyrë nga emri me “ bej ” që nuk e kishin përrën timer e tjerë, i vogël, disa herë e pata pyetur gjyshin se pse i thonë “ Përroi i Xhafer Beut.”

- Ai e ka patur përruan ? Ë gjysh ? Ma rrëfe !

Rrëfimin e tij e patëm dëgjuar gjithë familja disa herë si për herë të parë. Unë kënaqesha që gjyshi më merrte pranë gjurit e fillonte.

- Ja po të rrefej .Fshati ynë ka patur e ka nja dy a tre Xhaferë, por asnjëri nuk ka qenë bej. Ky i përroit nuk ka qenë nga fshati ynë.

- Po pe ngaj ishte ?

- Pe andej poshtë, - përgjigjej gjyshi.

- Nga andej poshtë, o gjysh ?

- As unë nuk e di tamam, po ta zemë se ishte pe Qukësi, - thoshte gjyshi.

- Gjysh, po simiten ky e humbi ?

- Jo. Është tjetër Xhafer ai i simites.

- Po, ku e humbi ?

- Në pazar. Tani, mbaj vesh; Xhaferë ka shumë e duhet të rrimë tërë natën me ta, po do të rrefej këtë të përroit që nuk humbi simiten, por humbi vetë pa nam e pa nishan.

- Gjysh, po ai përse erdhi këtu ? çfarë kërkonte ?

- Mortjen kërkonte dhe e gjeti.

Unë dëgjoja e shihja me vëmendje fytyrën e gjyshit për të marrë vesh se si e gjeti martjen Beu. Gjyshi vazhonte :

- Ngjarja, që thua ti çun, ka ndodhur një çikë më parë se të bëhesha unë. Sa kishte hyrë korriku, kur vjen rrotull shiniku. Fshatarët nuk i kishin paguar beut as xhelepet; as të dhjetat e bereqetit. Pak shtëpi ishin njëfarësoj. Shumica mbeteshin keq, pa bukë. Kishte nga ata që e korrnin elbin të pa bërë dhe e piquin në çerjep. Bukë e elbit bëhet e mirë, por do shumë punë.

Nese, Xhafer Beu, pa filluar drapëri dërgoi këtu një bej tjetër që e quanin Rushan.

Rushani ishte aq i lig sa tërë krahina nuk i thoshte Rushan beu, por Dushman, se vërtet dushman ishte.

Ai siç erdhi iku, duarbosh.

Kur e pa Rushanë e shoqëruesit prapa pa gjë Beut të madh i erdhi inat. Inat beu, bre bir i gjyshit. Si i tregoi Dushmani kështu e kështu shfryu :

“ Do të shkoj, vetë e shpirtin do t’iu marr. Ujë të zi do t’i nxjerr atij fshati.”

Beu i madh nuk lëvizte shumë nëpër krahinë se kishte Rushanë e Sulin ai për punë dhe për harxh. Kur ke mashën, pse...

Këtë “ për harxh ” nuk e thoshte Xhafer Beu se ishte i mënjëm qerratai, ndërsa atë “ për punë ” ua thoshte “ shpesh edhe Rushanit edhe Resulit”.

“ Ty të kam unë të zotin për punë.”

Filloi drapëri. Fshatarët po uronin njëri – tjetrin :

“ Gëzuar bukën e re ! ” Llafet që tha Beu erdhën në fshat përpara se ai të vinte vetë.

Gratë që kthenin vrahun në lëmë, në piskë të vapës e u shkonte djersa çurk, që shoshnin e bënin gati grurin për në mulli e morën vesh inatin e Beut e ç’kishte thënë.

E nga e keqja, për ta nxjerrë atë, mallkuan:

- Hej Zot, mos e sjell të kokën !

Nëna e Rustemit tha : Do vijë të na marrë shpirtin ? Po... lumi e marrë ! Përroi me dega e martë !

E xha Idrizit shtoi ; Ka thënë se ujë të zi

do na nxjerrë. Po uji i zi ia mbërçeltë atë gojë!

Një ditë më parë se të vinin këtu Xhafer Beu kishte urdhëruar Rushanin, Sulin e një tjetër që të nësërmen, në sabah të ishin gati. U bë sabah.

- Hazër Bej – tha Rushani.

- Mirë.

Para se Beu të hypte në kalë seç i kishte thënë veçan ca porosi komandantit te suvarinjve.

Se çfarë i tha, as Suli nuk e dinte.

Pastaj Xhaferi këmbën në yzengji e i hypi kalit të tij. U hypën edhe Rushani me Sulin, ndërsa ai tjetri, pa emër, u nis më këmbë.

- Pse o gjysh nuk kishte kalë për të ?

- Kishte kuaj beu, por ashtu e donte puna.

- Si e donte puna ?

- Të ecte përpara e të qëronte rrugën. Dhe ai kështu bënte, ecte rreth 30-40 hapa përpara tyre se helbete duke u ngjitur Kovaçicës së Krickovës, pas ndonjë kopaçi ose gëmushë, mund të dilte ndonjë lepur, kuajt do të tembeshin e do të hidhnin ndonjë bej në çaçkë të kokës.

Prandaj ai ecte e ruante sa majtas – djathtas. E po të ndodhte ndonjë gjë ta hante ai i pari.

Kur dual në Breg te Pojskës u duk fshati. Qëndruan e bënë sehir pa zbritur nga kuajt.

Rushani pa majtas, në arat me grurë turtuj e i tha Xhaferit :

- Shtjeru Bej !

Xhaferi sikur nuk desh.

- Shtjeru ! Te dëgjojë kryeplaku që erdhëm. E Xhaferi shtiu...

Disa laraska që ishin në kumbullat dhe lisat e xha Hamitit u trembën e fluturuan nga çukalet. Por edhe zarar bënë. Dy turtuj ranë. Të shtënat u dëgjuan deri në fshat e ata që po korrnin thanë :

“ Ata e paskan në terezi. Kohë për gjah është sot.”

Te Kroi i Gurëve u zbritën kuajve e u ulën ta ndezin nga një herë. Aty ka shumë dardha, por akoma nuk ishim bërë. Kur Beut i vajtën sytë tek një elbje. Ajo zverdhte.

- Hyp, - i tha atij tjetrit, - na merr ca dardha !

Ai sikur nuk desh. Po i vinte si turp.

Goxha burrë të hypte si fëmijë !

Por, kur i vete syri beut, s’ka turp. Nepsi është i keq.

Vajti ai të hypte, por elbja ishte shartuar më gorricë dhe kishte disa dega gorrice me gjemba.

Gjembat e gorricës janë të fortë, koçkore, e po të hynë në këmbë, të djegin shumë.

Xhafer Beu po e shikonte. Priste dardhat ai.

Rushani i bërtiste : Hyp ore !

- Po paska gjemba bej, s’hyp dot, -tha ai.

- Edhe po të shpuan një çikë do të shpojnë, - i tha Suli. O burra, mos na vono!

Me kujdes hypi. Mblidhte dhe ia hidhte Sulit që mundohej ti priste ndër duar.

Ato të shkreta të mira. Elbja është dardha e parë që bëhet. Kur duke ngrënë, dëgjuan : O !...

-ç’ke more ? Mos rrëzohesh !

-Më piskoi një grerëz në vesh.

Ata qeshën. Beu i madh i tha :

- Po ti me pishmanllëk hype. Hajde, hajde, unë të kam marrë për trim, të më ruash mua, ti bën “ O ” pe një grerëze. Zbrit, o zbrit !

Duke fërkuar veshin që i digjte filloi të zbrësë.

Një koçkar nga ata të gorricës, që u ruajt kur hypi, ia gërvishiti pulpën e këmbës.

Pse të mos qeshte Xhafer Beu ?

Vajti te kroi për të qullur veshin që po i enjtej pak.

- Kush i hëngri dardhat e kujt po i djeg veshi, - tha Rushan beu.

U ngritën, u hipën kuajve e u nisën. Ai i

veshit mbeti prapa. Në Somoshtina dy fshatarë që kishin vajtur pa hapur dita në mulli, kishin blujtur e tani po ngjiteshin.

- I sheh Bej , - kanë blujtur, - tha Suli. Beu nuk foli. Vetëm tundi kokën. Shenjë inati kjo. Pas pak i tha Rushanit që ecte pas tij :

- Më vjen inat edhe me atë kryeplakun.

Edhe ai anën e tyre mban..

- Ta ndërrojmë Bej, - tha Rushani.

- Po kë të vëmë pa ?...

Në këtë çast u dëgjua një e gjëmuar e fortë lart, nga bregu i Mollës.

- Zbraze !, - tha Rusha beu. Ta marrë vesh fshati se kush po vjen. Nuk i shkonte ndërmend se “ e zbrazura ” e Zotit ishte për ta. Nga Bregu i Mollës po varej poshtë nga Zimica një shtëllungë re e cila shpejt u nxi. Gjëmoi prap dhe ia dha shiu.

Po çfarë shiu, mor bir i gjyshit !

Ngriti më të lartë gurë e dhe. Gjthë gryka nga Zimica, në Vadhat e Rustemit, në Gropa e tatëpjete Sërkosave. Shiu, që ra me rrëmbim sikur donte ti dilte beut përpara, gërreu nga të dy anët e përroit të Sërkosave. Prishi edhe vathën e dhenvë të Meçollit që ishte pas përroit, në anë të arës.

Xhafer Beu me të tinjtë po nxitonte të hynte në fshat. Kur arritën te Lëndinat e Daros përroi oshëtinte e ujët sa vinte shtohet.

E panë. Shumë ujë. Të ktheheshin prapa, nëpër atë rrebes s’mundeshin. Ua mori mendja se do ta kapërxenin. U fut Xhaferi që të kalonte i pari. Në çast një valë e shtuar uji e gurë që fluturonin përpara. Një popël e goditi beun në kokë, në nofullën e majtë e ai u anua djathtas. Desh ra. Rushan beu u hodh shpejt nga kali i tij dhe e kapi Xhaferin të mos binte. I futi kokën nën sjetull si furkë dhe forcoi qafën që ta mbante. - “ Ru-shaan ! ” -

tha Beu me kokën e varur mbi supin e tij.

Gurët e goditën kalin në bark, këmbët iu ngatërruan e një trirë nga vatha i ra në gjoks.

Bëri të dalë, por s’mundi. Ujë e shtyri e kali ra me gjithë Xhaferë duke zënë përposh edhe Rushanë.

Uji nxinte se bashkë me dheun e arave ishte edhe plehu i vathës së Meçollit.

Xhafer Beut iu mbush goja me ujë të zi, iu mbërçel. Suli me atë tjetrin nuk i ndihmuan dot. Veç po bënin sehir... Përroi i perplasi me mezhden e xha Cefit e i fshiu Tatepjete.

Kështu, - bir, - e gjeti mortjen Xhafer beu. Deshi ti bëjë keq fshatit, po e gjeti nga Zoti.

- Gjyshi, po popël kujt i thonë ?

- Ja, atyre gurëve të rrumbullakët që ka nga Liqeri e nga lumi e që nuk thyhen.

- Po Beun nuk e gjetën më andej poshtë ?

- Jo. As Xhafer beun, as Rushan beun.

Përroi i shpuri në lumë e lumi s’dihet se ku i shpuri. Pas nja dy ditësh burrat e Krickovës, duke qeruar jazin e mullit nga balta gjetën një këpucë me tokez. Si këpucë pe Stambolli ngjante. E hodhën në lumët.

Sa e morën vesh homçanakët se përroi e mbyti Beun thanë : “ O Zot sa mirë ! Na shpëtove ! ” ndërsa për nënën e Rustemit dhe të xha Idrizit thanë : “ A... rrofshin ! E paskan pasur gojën hajmali.”

Kështu, bir i gjyshit. Kjo është historia e Xhafer Beut. Fshati shpëtoi për ca vjet. Nuk u duk asnjë bej. Më vonë u doli frika e filluan të vinin prapë. Por me fukananë kujdes!

Mos i hyrë shumë në hak ! Mos gënje !

As mos e kërcëno ! Po munde ndihmoje, të të ndihmojë ! Kaq ishte kjo mesele .

Si thua, flemë tani ?

- Flemë gjysh.

Pogradec, më 17 prill 2011



Ndahet nga jeta një nga gratë më jetëgjata shqiptare

Në Nju Xhersi u nda nga jeta një nga gratë më jetëgjata shqiptare. Demire Durollari ishte 115 vjeç dhe një dëshmitare e rrallë e zhvillimeve më të rëndësishme të botës shqiptare gjatë më shumë se një shekulli.

Zonja Durollari lindi në Hudënisht të Pogradecit më 14 shtator 1895 në një familje patriotësh. Në vitin 1949, ajo u arratis nga Shqipëria komuniste dhe jetoj 20 vjet në Shkup. Pas një qëndrimi në Itali, u vendos në Shtetet e Bashkuara. Zonja Durollari gëzonte vazhdimisht shëndet të mirë dhe me hapjen e Shqipërisë ajo është kthyer atje disa herë.

Në intervistat për mediat ajo ka thënë se sekretet e saj i jetëgjatësisë ka qenë ushqimi; ajo hante shumë peshk dhe bulmetra, nuk konsumonte as duhan as alkool. Zonja Demire Durollari lë pas tre fëmijë. Varrimi i saj bëhet sot në Nju Xhersi.

Erdhe ë? - tundi kokën buzëgaz profesor Klementi. - Do të vije, qeraxhiu me hanxhiun takohen një ditë, ja kështu.

I hapej goja. Ekskursioni në Sarandë me nxënësit e vitit të tretë e lodhi. Fjeti keq i pakënaqur nga një allishverish i vockël me çmimin e bileteve të autobuzit. Shoferi nuk e mbajti fjalën. Kjo e dëshpëroi pakëz, po ja ku doli përpara biznesmeni. U kujtua tani në fund të vitit shkollor.

Rrudhat në fytyrën e murrme shkëlqyen nga gëzimi që këndelli i sapoardhuri. Në vështrimin e përqëndruar lexohej hareja, sikur donte të thoshte:

"Më dole në pritë që thua ti".

Fajtori, Agron Sançolli, burrë i shkurtër, i pakët, qëndronte i përdëlyer tërë merak. Profesorin e takoi njëherë në fillim të vitit, më tej s'mundi. Mbahej me të keq në qytetin ku pati ardhur para dy vitesh. Shiste dru me kamjoncinën e vjetër. Buka e përditshme për tetë shpirt, vajza në universitet, qeraja e shetëpisë, s'i thoshin shaka. Jeta në qytet vështirësohej shumë.

Pamja prej zotërie e mësuesit e qetësoi disi, çështja nuk qënkej aq ligsh sa i patën thënë.

-Punët profesor, punët nuk na lënë, hë sot, hë nesër gjersa u ngeha. Si duket djali? Po mirë ë, - tundi kokën i sëndisur.

-S'është fjala për "jo mirë", me aq bënim si bënim, - u nxeh pak Klementi.

Nxori ngadalë tufën e testeve mbuluar me parakrah, kërkoi një copë herë, i vuri në duar fletën e Denis Sançollit. Aty, përveç emrit të kuptueshëm, vinte një faqe fletoreje nxirë nga dy anët, zhgarravitur me shkrim mjeran, gati të palexueshëm. Burri shtatvogël lexoi me zor:

"Vargu malor Trebeshinë Dhëmbel Nëmërkë ndodhet në masivin jugor të Shqipërisë me shtrirje verilindje jugperëndim...".

Ngriti kokën, diç deshi të thoshite, tjetri nuk e la.

-Ja kështu që thua ti, Denisi jo vetëm nuk mëson, po bën gabimin tjetër, kopjon.

Nga tufa e letrave nën sjetull i vuri përpara syve faqen e zhubrosur të librit. Djali e pati bërë sa një top të vogël, po syrit të profesorit nuk i shpëtonte asgjë. I bindur se çdo nxënës kopjon, kontrollonte në vende të fshehta, ku të tjerëve nuk u shkonte mendja. "Ja kështu", thoshte, "kjo qënka kopja tënde" dhe fap ia merrte fletën e testit e vendoste nën sjetull, sikur këpuste trëndafila.

-Nuk ka ngatërruar as pikë as presje, - e ledhatoi me shikim të butë Klementi dhe mori testet e palosi nën sjetull. - Që thua ti, s'kam ç'bëj, e sheh vetë, - u largua ngadalë me fytyrë të qeshur dhe dukjen e fëmijës tejet të pafajshme.

Agron Sançolli e pa veten me shpatulla pas murit, nuk dinte ç'të thoshte. Asnjë shenjë keqardhjeje në qenien kaba të profesorit. "I qeshur po i rreptë, nuk fal, të bind me argument të forta, të pakundërshtueshme", kishte dëgjuar të thoshin për të.

Argumentat e forta ishin testet. Askush nuk ka mundur ta shikojë pa fletën nën sjetull. Del nga shtëpia, pi kafe, shëtit nëpër oborrin e shkollës gjithnjë krahur e majtë mbledhur. Qëllon të mos ketë teste, po dorën e mban njëllj mbështetur pas trupit. Gabimet i gjuan qetësisht me buzë në gaz.

Prej njëzet vjetësh i pranishëm



Tregim nga Istref HAXHILLARI

Ja kështu...

sa shumë syresh nuk e mendojnë shkollën pa të. Drejtorët ikin e vinë, mësuesit gjithashtu, profesor Klementi jo. Shkolla do të humbte diçka thelbësore, po të largohej ai. Të rinjve u ngjan me vjetërsirat, sikur i përket një bote të huaj, mbuluar nga myku. Pamja plot ëmbëlsi e përkushtimit kishte diçka të pështrirë që i bënte mësuesit e tjerë të kthenin kokën menjëherë.

Kur hyri në sallë nuk pa asnjëri. Mbi dërrasën e zezë që shkruar me shkumës një lajmërim. Në pushimin e madh organizohej takimi për mbylljen e vitit shkollor. Me kujdes e shënoi në bllokun e mbledheve. Sallën e mësuesve e ka mbushur me harta gjithëfarëloj fizike, politike, të shteteve, kontinenteve. Kolegët vështrojnë të detyruar hartat si në një kabinet të përhershëm gjeografisë.

Atë mëngjes shëtit para hartave, hoqi njërën e vendosi në anën tjetër. Nxori skicën e madhe të fiseve ilire, zuri dy radhë në faqen e murit. Me kujdes zhvendosi tabelën e Mendelejevit në cepin e futur të sallës, ku s'binte fort në sy. Skica e trojeve ilire u shpalos krenarisht në tërë pjesën ballore. Profetori shkëlqeu në kraut të hartës.

Kolegët mezi e duronin këtë rit foshnjor të përditshëm.

-Goxha i madh paska qenë fisi i enkelejeve, - i tha pak i habitur e i menduar Beni, mësuesi i anglishtes.

Beni argëtohet, e ngacmon shpesh larg e larg, pa e bërë veten, po Klementi nuk mërzhitet as ofendohet.

-Enkelejtë mor djalë u shtuan, u bënë fis i madh. Që thua ti ky vend është zanafilla e Ilirisë. Kadmi dhe Harmonia djalin e vetëm, që e shtriu sundimin në tërë viset tona, e quajtën Ilir. Kadmi pati edhe një motër, Europën që i dha emrin kontinentit plak. Ja kështu, - qeshi i kënaqur plot dritë diturie profesori i gjeografisë.

Beni hokatar vazhdoi me të tijën. -Pa shiko, këto nuk i kam dëgjuar asnjëherë, ja pse ka nevojë shkolla për mësuesë të aftë, të përkushtuar.

Zilja elektrike lajmëroi fillimin e mësimit. Klementi mori globin në dorën e djathtë, të majtën fletën e testit dhe ngadalë në mënyrë ceremoniale hyri në klasë. Aty një pjesë të mësimit e harxhoi për hokat e za-

konshme plot kripë.

-Moj çupë, paska ndryshuar modelin e flokëve, kështu ë, - qeshi me të madhe babaxhani i pafajshëm.

Vajza hyri me kënaqësi në lojë. Nxënësit e kanë për zemër këtë pjesë argëtuese të mësimit.

-Pashë në televizor modelin, më pëlqeu, thashë t'i bëj edhe unë. Ato çfarë kanë më shumë se ne profesor?

Klasa qeshi, Klementi ca më shumë. Njëri nga djemtë tha se edhe Teuta sikur i ka ndryshuar, po Klementi vuri re se nuk qe e vërtetë.

-Pusho more mistrec, - kërcënoi buzëqeshur, pa hijen më të vogël të pezmit në fytyrën bukuroshe të paruar.

Pastaj u bë përnjëherë serioz, vërejtje vetullat kaleshe, uli sytë e hirtë mbi regjistër.

Kjo pamje nuk i shkante hiç. -Tani që thoni ju fillojmë të pyesim se avullon ora dhe s'kemi kohë të shpjegojmë, ja kështu.

Pasi mbaroi pushimi i vogël dhe ra zilja e orës tjetër, doli madhështor, dërdëng. Tufa e përhershme e testeve së bashku me regjistrin nën sjetull, ndërsa harta stërgjatë në dorën e djathtë zuri gjysmën e korridorit, pengonte lëvizjen. Dukej si ndonjë maune mallrash mes mësuesve dhe nxënësve që nxitonin sa andej-këtej.

Ai vetëm qeshi hijshëm.

Në pushimin e madh u vërtit nëpër sallë, i afërt me të gjithë, i dashur. Krahur e majtë ngritur si paralitik nuk e ulte. Dikush tha se edhe në gjumë mbledhur duhet ta mbante dorën Klementi.

Në takimin për mbylljen e vitit shkollor shkëlqeu. Të gjithë nga një fletë dosido përpara, ai nxorri bllokun e madh të mbledhjeve, stilolapsin, në gatishmëri të mbante shënim me seriozitet solemn.

Shikoi me qortim Benin në kraut pas asgjë përpara.

-Aguridhe mbte, me se do shkruash. - qeshi pa zë dhe i zgajti një copë letër të grisur keq nga bllokun.

Drejtori ndau formularët e përvitshëm. Sapo filloi të sqaronte përmbajtjen, Klementi e ndërpreu.

-Zoti drejtor, pasqyra 3/a ka një gabim, në vend të vitit shkollor 2009-2010 shkruhet 2008-2009, e keni vënë re? - ngriti kokën triumfator, i vetëkënaqur.

Dikush sugjeroi me djallëzi.

-Që të jesh brenda vere 2007-2008.

Qeshën të gjithë, Klementi jo. Me kompetencë të admirueshme sqaroi se gabime të tilla, vërtet të rastit, ngatërrojnë vitet shkollorë me njëritjetrin dhe mund të sjellin pështrjelim nëpër zyrat arsimore. Statistikat hidhen në kompjuter. A mund të ndajë kompjuteri vitet e shkruar njëllj? Në sytë e mëdhenj prej foshnjeje shprehej habi. Si nuk e kuptonin të tjerët rëndësinë e këtij gabimi delikat?

Doemos kishte të drejtë.

Sapo mbaroi mbledhja, iu afrua Mariës. Ajo seç bënte me regjistrin.

Maria, mësuesja më e bukur e shkollës, me fytyrë të ftohtë indiferente shikonte punën e saj. Kullohet mbi regjistër, përpjet sa mundet po nuk ia del. Në çdo mbledhje kritikohet për korrigjime notash, mungesat, gjeneralitetet. Për shkak të gabimeve muajin e shkruar zëvendësoi një faqe të zhgarravitur regjistri me faqe të pastër, po sërish bëri korrigjime!

Nuk u shpëton dot gabimeve. Klementi e ngacmoi plot dashamirësi.

-Mbetë me regjistër në dorë moj e uruar, çfarë i bën, ta marrim vesh edhe ne, - buçiti me gurgullimat e zërit të qashtë.

Maria u përgjigj ashpër pa ngritur kokën nga regjistri.

-Ja ke ngenë ti, - dhe vazhdoi punën.

Klementi u përku të shikonte hollësisht, po ajo mbylli regjistrin. Nuk e duronte erën e tij prej urithi sapodalë nga nëntoka.

-Lahet ndonjëherë ky njeri? - u thoshte shpesh në koefidencë shoqëve të afërta.

Maria u largua nga salla, ndoshta në banjë, duke lënë pas aromën e këndshme femërore, diçka tepër eksituese. Fustani i modës së fundit, ngjitur pas trupit nxirte në pah gjoksin e hatashëm dhe rrumbullakësinë e kofshëve të ngjeshura. Burrat e ndoqën me sy. Shoqet e ngushta thonë se ka qeskën e urinës të vogël.

Sigurisht kanë zili freskinë e saj. Kureshtar prej natyre, Klementi ngatërrohej nëpër këmbë si punë bullari, nuk shqitej lehtë. S'mund të duronte vetminë midis njerëzve.

Si shkoi huq Maria, u krodh plot kërshtëri në hullinë e ëndshme të fut-

bollit me mësuesit e fizikulturës. Ata rrinë gjithnjë nga fundi i sallës me topa nëpër këmbë.

-Po mirë o si na e bëri Interi dje ë? Gjermani shmangu katër lojtarë, bëri gol, ja kështu që thua ti Namik. E ndoqe apo jo?

Namiku nuk pati thënë ndonjë gjë deri atëhere. Shikoi i bezdisur Klementin.

-Sulmuesi qe në pozicion jashtë loje, një pëllëmbë përpara topit, arbitri nuk e pa. Më beso mua ndeshje e trukur, - foli me përgjegjësi.

Namiku ishte zëvendëstrajner i skuadrës së qytetit.

-E ke gabim që thua ti, - ia priti Klementi, - interist je, e dimë, ama gjer këtu jo. Nuk ahahet Interi me Bajernin.

Shtjelloi gjërë e gjatë lojën me hollësi dhe argumenta të bollshme. Vështirë të bënte përpara Interi nga shkaku i klaneve kundërshtare që nuk e linin trajnerin të përzgjidhte ekipin. Italianët s'qenë në ditët më të mira. Se nga i dinte hollësisht vështirë ta merrje vesh. Namiku u tërhoq.

Kishte edhe një porosi për Klementin.

-Më duket ke të drejtë, - i bëri qefin, - nuk e kam vënë re aq mirë, m'u duk pozicion jashtë loje dhjetëshi i Bajernit.

Klementi, përkëdhelur në sedër, me pamje ëngjëlli shikoi përreth fitimtar. Shumica nuk e patën mendjen.

Ra zilja, mësuesit hynë nëpër klasa. Klementi s'dinte ç'të bënte, atë orë qe bosh. Pushimin nuk e duron, e ha përbrenda.

-Kur do të pimë një kafe bashkë, - i tha Namiku.

-Kur të duash ti shpirt, tani po deshe, - ia ktheu Klementi, shend e verë.

Dolën duke biseduar me zë të lartë. Nga larg dallohej figura e mbushur plot gaz e profesorit të gjeografisë.

Dielli ngrohte oborrin e lulëzuar, zogjtë fluturonin nga njëra pemë te tjetra, gjithësisht qeshte. Natyra e rilindur nga shirat e verës, cicërimat e shpendëve, gjelbërimi i harlisur e lumturuan Klementin, i sollën kënaqësi të thellë. U gjallërua, zuri të flasë papushim. Në klubin pranë shkollës piu një gotë raki, ndezi cigaren e hollë slims, erdhi e u bë më i gëzuar. Rrezatonte hare me të gjitha qelizat e trupit.

-Nuk të kam thënë më parë, tani e mora vesh, - hyri në thelbin e çështjes Namiku. - Si do të bësh me Denis Sançollin, e kam radhë miku.

-Për këtë më thirre? - reagoi plot kënaqësi Klementi dhe fësht nxori nga nënsjetulla testin e tij.

-Shikoje të kam rixha. Pasi tha këto fjalë, qeshi me të madhe.

Namiku u përpoq të lexonte, po nuk deshifronte shkrimin.

-Të bardhë nuk e ka dorëzuar de! Veri një pesë, mbylle këtë muhabet.

-Ashtu thua ti? Vështro këtu, ballafaqoqi, - i zgjati fletën e grisur të librit.

-Ka ndonjë zgjidhje? - dorëzoi armët Namiku.

Klementi e vështroi butësisht i mallëngjyer.

-Ka, si s'ka. Agroni biznesmen, vjen vërdallë ditë për ditë me dru, furnizion tërë qytetin, ja kështu që thua ti.

Dhe nënqeshi plot ëmbëlsi.

Pogradec,
e mërkurrë 14 korrik 2010